



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Produato Received/Delivery	20.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt + Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSKICK	4216/2022		119

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.501/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.501/2022 të datës 06.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Agjencia e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike, "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20.07.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.501/2022 e datës 06.06.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Masa disiplinore "Vërejtje" me numër reference: ARC/DPD/M.TH/23/2022 e datës 18.05.2022.
- III. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi, i punësuar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Patentë Shofer në Agjencinë e Regjistrimit Civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 06.06.2022 ka

parashtruar ankesë me numër protokoll 3265/2022 të regjistruar me numër A.nr.501/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" me numër reference: ARC/DPD/M.TH/23/2022 e datës 18.05.2022, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, shkeljes së dispozitave të Ligjit për Zyrtaret Publikë, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 13.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 23.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesa e ankuesit e datës 06.06.2022 me numër protokoll 3265/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 19.05.2022 -njoftim për vërejtje me shkrim dhe vendosje në dosje; Vërejtje me shkrimë e datës 18.05.2022 ; E-mail zyrtar i datës 10.05.2022; E-mail i datës 19.05.2022; E-mail zyrtar të datës 19.05.2022; E-mail zyrtar i datës 27.04.2022; E-mail zyrtar i datës 22.04.2022; E-mail zyrtar i datës 02.03.2022; E-mail zyrtar i datës 28.04.2022; E-mail zyrtar i datës 22.04.2022-lënda e aplikimit për për palën E-mail i datës 22.02..2022; E-mail zyrtar i datës 14.03.2022; E-mail zyrtar i datës 10.03.2022; E-mail zyrtar i datës i datës 20.04.2022; E-mail zyrtar i datës 19.04.2022; Vërtetim për konfirmimin e të dhënave të patent shoferë i datës 30.03.2022; E-mail zyrtar i datës 28.03.2022; E-mail zyrtar i datës 28.03.2022 - përgjigje lidhur me çështjen e lëshimit të vërtetimit -verifikimit të patentë shoferë; E-mail zyrtar i datës 24.03.2022 -opinion ligjor; E-mail zyrtar i datës 23.03.2022; E-mail zyrtar i datës 22.03.2022; Llojet e drejtimit të automjeteve; E-mail zyrtar i datës 01.03.2022; E-mail zyrtar i datës 18.03.2022; E-mail zyrtar i datës 23.03.2022; E-mail zyrtar i datës 29.09.2021;E-mail zyrtar i datës 15.04.2022; E-mail zyrtar i datës 11.03.2021-takim pune; E-mail zyrtar i datës 18.03.2021; E-mail zyrtar i datës 15.05.2022; E-mail zyrtar i datës 04.04.2022-njoftim; E-mail zyrtar i datës 05.05.2022-kërkesë; E-mail zyrtar i datës 18.05.2022; E-mail zyrtar i datës 06.05.2022; E-mail zyrtar i datës 30.05.2022; E-mail zyrtar i datës 23.05.2022; Libri i Protokollit për vërtetimin e lëshuar nga DPSH për vitin 2022; E-mail zyrtar i datës 02.03.2022; E-mail zyrtar i datës 05.04.2022; E-mail zyrtar i datës 07.03.2022; Raport i prezencës në punë për periudhën01.05.2022 deri më datën31.05.2022; E-mail zyrtar i datës 27.04.2022-njoftim për vërejtje ; E-mail zyrtar i datës 27.04.2022-për Drejtorin; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 23.06.2022 me numër protokoll 3647/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 30.01.2013; Vërejtja me shkrim e datës 18.05.2022 me nr.308; E-mail zyrtar i datës 22.04.2022; E-mail zyrtar i datës 22.04.2022 ; E-mail zyrtar i datës 29.03.2022E-mail zyrtar i datës 21.02.2022; E-mail zyrtar i datës 20.06.2022 nga Menaxheri i Personelit -njoftim; E-mail zyrtar i datës 10.06.2022; E-mail zyrtar i datës 10.06.2022 kërkesë; E-mail zyrtar i datës 20.06.2022; E-mail zyrtar i datës 10.06.2022; E-mail zyrtar i datës 10.06.2022; E-mail zyrtar i datës 22.04.2022 lënda e aplikimit për patent shofera; E-mail zyrtar i datës 21.04.2022; E-mail zyrtar i datës 29.03.2022; E-mail zyrtar i datës 21.02.2022E-mail zyrtar i datës 21.02.2022; E-mail zyrtar i datës 28.01.2022; E-mail zyrtar i datës 12.04.2022; E-mail zyrtar i datës 29.03.2022 -ftesë për takim; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022; E-mail zyrtar i datës 28.01.2022 -ftesë për takim; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022; E-mail zyrtar i datës 16.11.2021; E-mail zyrtar i datës 06.04.2022-ftesë për takim me udhëheqësit e QPD-ve; E-mail zyrtar i datës 28.03.2022; E-mail zyrtar i datës 28.03.2022-përgjigje lidhur me çështjen e lëshimit të verifikimit të patentë shoferëve; E-mail zyrtar i datës



24.03.2022; E-mail zyrtar i datës 23.03.2022; E-mail zyrtar i datës 23.03.2022 për Drejtorin; E-mail zyrtar i datës 21.06.2022 dhe Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 04.02.2013 mban pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Patentë Shofer në kuadër të Departamentit të Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë-Shoferëve - Agjencinë e Regjistrimit Civil. Me datë 18.05.2022 Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente, në cilësinë e udhëheqësi të drejtpërdrejtë, ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" me numër Reference: ARC/DPD/M.TH/23/2022.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar me datë 06.06.2022 pretendon se masa disiplinore e shqiptuar me datë 18.05.2022 është nxjerr përmes shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, shkeljes se dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar aktin me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ankuesit, gjegjësisht Vërejtjen me numër Reference: ARC/DPD/M.TH/23/2022 të datës 18.05.2022, dhe rrjedhimisht duke ju referuar dispozitave të nenit 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka konstatuar se i njëjti nuk i përmban elementet kryesore të aktit administrativ, respektivisht akti me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore nuk përmban bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, si dhe mungon kualifikimi i veprës disiplinore.

Me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 47 paragrafi 1 përcaktohet se: 1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse,... 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin)... 1.3 pjesën arsyetuese... dhe 1.4 pjesën përmbyllëse, ndërsa me nenin 48 po të njëjtit ligj përcaktohet se: 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Kolegji i Këshillit me rastin e analizimit të Aktit administrativ me numër Reference: ARC/DPD/M.TH/23/2022 të datës 18.05.2022, ka gjetur se i njëjti përmban vetëm një përshkrim të gjendjes faktike mirëpo si i tillë nuk përmban bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, dhe si rrjedhojë mungon kualifikimi juridik i veprimeve në kuptim të nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe nenit 5 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Po ashtu akti i kontestuar nuk përmban pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike).

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji i Këshillit konstaton se akti i kontestuar me numër Reference: ARC/DPD/M.TH/23/2022 i datës 18.05.2022 është akt administrativ i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe për këtë arsye vendosi për shfuqizimin e te njëjtit siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi. Ndërsa për shkak të paligjshmërisë së aktit të kontestuar në kuptim të shkeljes së dispozitave procedurale, Kolegji i Këshillit nuk ka mundur të lëshohet në shqyrtim meritor të çështjes. Kolegji i Këshillit vlerëson se organi i punësimit në të ardhmen duhet të marrë parasysh të gjeturat dhe vërejtjet e dhëna përmes këtij vendimi, ngase vetëm evidentimi i shkeljeve të pretenduara të paraqitura në përmbajtjen e masës disiplinore nuk është i mjaftueshëm, pasi që është e nevojshme të përcaktohet edhe natyra e shkeljes së pretenduar disiplinore sipas dispozitave të nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase edhe kompetenca për të shqiptuar masat disiplinore rrjedh apo është e lidhur ngushtë me natyrën e shkeljes disiplinore.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe të gjeturave të pasqyruar si në arsyetim të këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.501/2022**

**Flakron Gashi**

Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

